SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private të prekura nga ndërtimi dhe rehabilitimi i segmentit rrugor Ura e Bunës-Murriqan.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i posaçëm i shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur. Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Sqarojmë se në kolonën “Shënime” në tabelën e publikuar, për të gjithë pronarët që janë bërë shënimet “plotësim dokumentacioni”, “mungon kartela e pasurisë”, paratë do të qëndrojnë të bllokuara në bankë deri në momentin që do të paraqesin dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme pronë private për interes publik”.